

KËRKESË
Nr. 6357/4, datë 28.10.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajguore.

Subjekti kërkuar i shpronësimit është Bashkia Ura Vajguore.

Me anë të këtij publikimi, kërkohet që të vihet në dijeni personi i cili preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajguore, për shpronësimin e pasurisë së tij, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall” dhe për vlerësimin e pasurisë së llojit “ndërtesë”, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit (paraprake) është 51,935 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIMI URBAN DHE SISTEMIMI I FSHATIT DONOFROSË, NJËSIA ADMINISTRATIVE CUKALAT”, BASHKIA URA VAJGUORE

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i objektit	Sipërfaqe truall	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit	Vlera e truallit	Vlera e ndërtimit	Vlera e truallit dhe e ndërtesës	Shënime
					m ²	m ²	lekë/m ²	lekë	lekë	lekë	
1	Altin Flamur Metohu	1515	52/19	ndërtesë + truall	200	70	203	40,600	11,335	51,935	Llogaritjet janë kryer duke u mbështetur në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”; udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”; VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; VKM-në nr. 401, datë 23.10.1989, “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”; Çmimet e Entit Kombëtar të Banesave të miratuara me udhëzimin e KM-së nr. 3, datë 28.12.2016, aktualisht në fuqi.
VLERA TOTALE								40,600	11,335	51,935	
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT										51,935	